



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:001844

Datë: 06.10.2022

Numri i dokumentit: 03498279

P.nr. 1/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. (A.) D. nga S.Rr. “.”, për shkak të veprës penale deklarim i rremë nga neni 384 par.1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës PP/II.nr.1610/2020 të dt. 30.12.2020, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 12.07.2022, në prezencën e prokurorit të shtetit Sadri Alija, të akuzuarit A. D., **më 15 korrik 2022 nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.D.** nga i ati A., e ëma H., e gjinisë P., i lindur më ..., nga S. Rr. “...”, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i dënuar, i martuar, i ati i 1 fëmije, ka të kryer Fakultetin e Kriminalistikës në Kolegjin ..., pronar i kafiterisë “Sh. e v.” në S., i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Më datë 11.12.2020, rreth orës 15:45/h, në fshatin K., Komuna e M., me vetëdije deklaroi identitet të rrejshëm para zyrtarëve policor, në atë mënyrë që pasi zyrtarët policor të njësisë së trafikut kishin ndalur të pandehurin për tejkalim të shpejtësie dhe nga i njëjti ishte kërkuar prezantimi i tij me anë të dokumenteve, i pandehuri deklaroi rrejshëm duke prezantuar shënimet e vëllait të tij N. D., ashtu që pas verifikimit në bazën e të dhënave policore rezultoi se N. D., është i kërkuar me urdhër arrest, dhe pas shoqërimit të pandehurit në stacionin policor, i njëjti pohon se emri i tij është A. D., ndërsa N. D. është vëllai i tij, me ç’ rast me qëllim që ti shmanget përgjegjësisë, deklaroi rrejshëm duke dëmtuar personin tjetër për të cilin ka qenë në dijeni që nuk ka kryer veprë.

- me çka ka kryer veprë penale deklarim i rremë nga neni 384 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,6,7,17,38,39,40 par. 1 nën par. 1.2, 1.3,42,43,44,69,70,384 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 248,365 të KPPK-së, të akuzuarit **A. D.** i shqipton,

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME BURGIM

Ashtu që i akuzuari **A.D.** dënohet me dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) euro, si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej pesë (5) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 44 par. 1 dhe par. 2 të KPRK-së, të pandehurit **A. D.** i shqipton,

DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT I ZËVENDËSOHET NË DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit **A. D.**, për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh, i cili dënim në bazë të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit **A. D.**, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) euro.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj dënimin e zëvendësuar me gjobë, atëherë dënimi i zëvendësuar me gjobë do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditësh.

Të pandehurit A. D., Gjykata ia cakton dënimin UNIK me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro, të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në tre (3) këste në afatin prej tre (3) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit dhe atë kësti i parë do të paguhet deri më datën 05, të muajit të parë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, kësti i dytë do të paguhet deri më datën 05, të muajit të dytë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, dhe këstin e tretë do të paguhet deri më datën 05, të muajit të tretë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,00 €, për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP.nr.1610/2020, të datës 30.12.2020, kundër të akuzuarit A. D. nga S. Rr. "...", për shkak të veprës penale deklarim i rremë nga neni 384 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 12.07.2022, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohen të pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurve se ndjehen fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga të

pandehurit pasi që është bindur plotësisht se ishin të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri A. D., deklarohej i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilin jam penduar, andaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që mos të kryej vepër penale, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më dënoj më burg dhe të njëjtën t'i zëvendësoj më dënim më gjobë.

Nga thëniet e vet të pandehurve në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ata me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tyre kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit, nr. i rastit ..., të dt.11.12.2020; raporti i policit B. K. ..., nr. i rastit ..., të dt.11.12.2020, dhënë në Stacionin Policor Malishevë; procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.D., nr. i rastit ..., të dt.11.12.2020, dhënë në Stacionin Policor Malishevë; informacione rreth shkëlqes së trafikut nr.0..., të datës 13.08.2020; fletëparaqitje për kundërvajtje, tejkalim i shpejtësisë, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e vepra penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si rrethanë lehtësuese, gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë në shqyrtimin fillestar, është penduar dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërit vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rëndues gjykata mori faktin se i akuzuari ka kryer vepër penale edhe më parë atë sipas lëndës: **I.** P.nr 239/2014, i dënuar me dënim me kusht 1 vit burg, brenda dy vitesh, sipas nenit 410 të KPK-së, i plotfuqishme me datë 18.08.2016; dhe **II.** Sipas lëndës P.nr.150/2018, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej 500 euro, sipas nenit 374/1 të KPK-së, e plotfuqishme me datë 25.04.2019. Gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënim unik me gjobë me shumën prej pesëqind (500) euro, me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi e dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të PRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2. 6 të KPPK-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3. 2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Nga sa u tha më lart, në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.1/2021 datë 15 korrik 2022**

**Zyrtarja ligjore,
Albane MORINA**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.